

Republika e Kosovës-Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Ministrastvo Finansija, Rada i Transfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers



Agjencia e e Punësimit e Republikës së Kosovës
Agencija za Zapošljavanje Republike Kosovo
Employment Agency of the Republic of Kosovo



Komuna e Drenasit/Gllgocit
Opština Drenas/Glogovac
Municipality of Drenas/Gllgoc

Marrëveshje Bashkëpunimi


mes

Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), në kuadër të Ministrisë për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare (MPFVLÇ), përfaqësuar nga z. Blerim Hasani, U.D. Drejtor Ekzekutiv i APRK

dhe

Komuna e Drenasit (Komuna), përfaqësuar nga z. Ramiz Lladrovci,
Kryetar i Komunës

Duke ju referuar



Handwritten signature or mark.

Ligjit Nr.05/L-077 për Regjistrimin dhe Ofrimin e Shërbimeve për të Papunët, Punëkërkuarit dhe Punëdhënësit dhe Ligjit Nr.04/L-205 për Agjencinë e punësimit të Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të partneritetit, palët e sipërpërmendura pajtohen që të bashkëpunojnë rreth realizimit të masës Praktikë në Punë konform nenit 21 të Rregullores 01/2018, për masat aktive të tregut të punës, **lidhin këtë:**

Marrëveshje Bashkëpunimi

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit (më tutje: marrëveshja), ndërmjet Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës/MPFVLÇ (më tutje APRK) dhe Komunës së Drenasit (më tutje KOMUNA) është realizimi i masës Praktikë në Punë për angazhimin e 5 (pesë) punëkërkuarve të regjistruar në kuadër të Zyrave të Punësimit, për një periudhë kohore 6 (gjashtë) mujore.
2. Duke marrë parasysh specifikën e kërkesës që do të realizohet nga Komuna , do të angazhohen punëkërkuar të regjistruar si të papunë, në Zyrat e Punësimit sipas kritereve të paracaktuara nga punëdhënësi (shih shkresën e Komuna me Nr. 400/01-53795/249).
3. Praktikë në Punë (PNP) iu ofrohet punëkërkuarve mundësinë e përfitimit të përvojës së nevojshme në mjedisin e punës për të filluar në një profesion të caktuar ose një fushë të karrierës.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përcakton detyrat dhe kushtet e bashkëpunimit në mes të APRK/MPFVLÇ dhe Komunës në zhvillimin dhe realizimin e praktikës në punë, sipas detyrave të punës të përcaktuara nga Komuna.
2. Kompensimi i praktikantit/es është në vlerën prej 425.00 euro, bazuar në Vendimin Nr. 10/273 të dt.31.10.2025 dhe Rregulloren e (MPMS) Nr.01/2018 për Masat Aktive të Tregut të Punës të Neni 25 paragrafi 1.
3. Programi i MATP Praktikë në Punë, si në nenin 1 të kësaj Marrëveshje do të angazhojë 5 (pesë) punëkërkuar për 6 (gjashtë) muaj radhazi me kompensim mujor prej 300.00 €, nga ana e APRK-ës. Ky kompensim mujor do të përdoret për nevojat e ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera ditore. Praktika në Punë do të realizohet pranë zyrave përkatëse të Komunës dhe njësive vartëse të saj.

Neni 3

Kohëzgjatja

Marrëveshja do të fillojë së zbatuari me datë **02.04.2026 deri me datë 02.10.2026.**

(Signature)



Neni 4 Baza e Bashkëpunimit

Bazë e bashkëpunimit për realizimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit është legjislacioni i aplikueshëm i Republikës së Kosovës, nga fusha e tregut të punës.

Neni 5 Të drejtat dhe përgjegjësitë e APRK

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e APRK janë si në vijim:
 - 1.1. Të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej **9,000.00 €** (nëntëmijë euro) për kompensimin e 5 (pesë) punëkërkuessve të angazhuar në masën "Praktikë në Punë" në vlerën prej 300.00 € në muaj për 1 (një) praktikantë, për nevojat e ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera ditore, si dhe të bashkëpunon me Komunën - në lidhur me realizimin e detyrave nga Marrëveshja e Bashkëpunimit në fjalë;
 - 1.2. APRK do të paguaj kompensimin për 1 (një) punëkërkuess të angazhuar në shumën prej 300.00 € për muaj, kompensim ky që bëhet në xhirollogarinë bankare të punëkërkuessit të angazhuar në kuadër të masës praktikë në punë;
 - 1.3. Zyrat e Punësimit përgatisin listën e gjere te punëkërkuessve (nga SIMP) bazuar ne vendet e lira te punës dhe propozojnë këtë liste për përzgjedhje tek Komuna (sipas kriterëve të specifikuar në shkresën e bashkangjitur);
 - 1.4. Pas pranimit te listës finale e nënshkruar dhe aprovuar nga Komuna, Udhëheqësi i Zyrës së Punësimit nënshkruan marrëveshjen individuale me punëkërkuessin e angazhuar për realizimin e masës e cila përmban të drejta dhe detyrime të palëve që marrin pjesë në implementimin e masës aktive;
 - 1.5. Të monitoroj mbi baza ditore, javore dhe mujore vijueshmërinë e punëtorëve në punë, dhe të pranoj rregullisht çdo fund muaji listën individuale të vijueshmërisë dhe detyrave të realizuara nga secili punëkërkuess i/e angazhuar. Lista e vijueshmërisë duhet të jetë e nënshkruar dhe aprovuar nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i caktuar nga Komuna dhe të njëjtën ta dorëzojë në Zyrën e Punësimit ku punëkërkuessi ka nënshkruar marrëveshjen individuale në mënyrë që ti realizohet kompensimi mujor.
 - 1.6. APRK nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim tjetër si, ndonjë dëmtim të pajisjeve në punë, shpenzimet ne rast aksidenti apo sëmundjes se pjesëmarrësit gjatë implementimit të masës;
 - 1.7. APRK konkretisht Drejtori Ekzekutiv i APRK-ës cakton Zyrat e Punësimit në Komuna të koordinohen me Zyrtarin e caktuar nga Komuna.

Neni 6 Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës

1. Të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës-së janë:
 - 1.1. Të sigurojë mjetet financiare në vlerë prej mjete financiare prej **4.875.00 euro** (katërmijë e tetëqind e shtadhjetë e pesë) për kompensimin e 5 (pesë) punëkërkuessve te angazhuar ne masën "Praktike ne pune", në vlerën prej 125.00/200 euro në muaj për 1 (një) praktikantë, për nevojat e ushqimit, udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera

M

- ditore, si dhe të bashkëpunon me APRK- në lidhur me realizimin e detyrave nga Marrëveshja e Bashkëpunimit në fjalë;
- 1.2. Komuna do të paguaj kompensimin për 1(një) punëkërkuar në shumën prej 125.00 € për muaj deri në muajin Qershor 2026, ndërsa nga muaj Korrik 2026 në shumën prej 200.00 €, kompensim ky që bëhet në xhirollogarinë bankare të punëkërkuarit të angazhuar në kuadër të masës praktikë në punë;
 - 1.3. Do të bej përzgjedhjen e punëkërkuarëve nga lista e gjere e dërguar nga APRK, të cilët do të angazhohen në MATP “praktikë në punë”, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në pikën 1.3 të nenit 5, të kësaj marrëveshje;
 - 1.4. Lista finale e nënshkruar dhe aprovuar nga Komuna dërgohet tek Udhëheqësi i ZP-ës;
 - 1.5. Përcjellë angazhimin, mbikëqyrjen dhe udhëheqjen e praktikantëve mbi baza ditore dhe të përgatitë raporte periodike për angazhimin e tyre;
 - 1.6. Pajtohet se gjatë praktikës do të sigurojë një mjedis të sigurt dhe mbrojtje e siguri në punë në përputhje me Ligjin Nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës;
 - 1.7. Për secilin punëkërkuar të angazhuar përcakton detyrat dhe përgjegjësit që duhet realizuar gjatë kohës që është i angazhuar në Praktikë në Punë. Cakton mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë i cili është përgjegjës edhe për aprovimin dhe nënshkrimin e listës së vijueshmërisë dhe detyrave të realizuara gjatë muajit përkatës nga punëkërkuar i angazhuar;
 - 1.8. Siguron që punëkërkuar i gjatë angazhimit të tij/saj 6 (gjashtë) mujor, do të përvetësojnë njohurit dhe shkathtësitë themelore të punës sipas detyrave dhe përgjegjësi të përcaktuara dhe se do të jenë të gatshëm për tregun e punës pas përfundimit të angazhimit;
 - 1.9. Përcakton departamentet, zyrat dhe njësitë se ku do të caktohen praktikantët varësisht nga profili i tij dhe përcaktimi i aktiviteteve për praktikë në punë dhe njofton APRK, Zyrën përkatëse të Punësimit;
 - 1.10. Komuna do të njoftojë Zyrën e Punësimit nëse ai/ajo nuk është i kënaqur me praktikantët brenda 10 ditëve të para kalendrike të vendosjes (periudhës provuese) dhe mund kërkoj zëvendësim dhe po ashtu nuk do të ketë kompensim gjatë kësaj periudhe;
 - 1.11. Në rast se ndërprejë marrëveshjen me praktikant/in brenda periudhës së përcaktuar, Komuna është e obliguar që të njofton me shkrim menjëherë Zyrën e Punësimit;
 - 1.12. Komuna mundëson monitorimin e realizimit të masës praktikë në punë nga ana e Këshilltareve të Zyrës së Punësimit përkatës dhe njofton APRK-ës lidhur me sfidat dhe vështirësitë e mundshme gjatë realizimit të praktikës në punë;
 - 1.13. Shqyrton, aprovon dhe nënshkruan listën e vijueshmërinë dhe detyrave të realizuara të punëkërkuarit të angazhuar për çdo muaj e cila listë duhet të dorëzohet nga vetë punëkërkuar i në Zyrën e Punësimit në mënyrë që të procedohet pagesa për kompensim;
 - 1.14. Komuna lëshon letër reference për praktikantët që kanë kryer me sukses Programin e masës aktive të tregut të punës praktikë në punë.
 - 1.15. Kryetari i Komunës cakton një zyrtar përgjegjës që do të jetë në koordinim me Zyrat e Punësimit të APRK-se.

Neni 7

Mos pajtimet dhe paqartësitë

1. Secila palë nënshkruese e marrëveshjes mund ta ndërprejë marrëveshjen brenda tridhjetë (30) ditëve pas dhënies së njoftimit me shkrim, nëse pala tjetër nuk është në gjendje apo në ndonjë mënyrë pengohet në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të veta sipas

marrëveshjes, duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të projektit, me kusht që palët janë konsultuar, por pa sukses në përpjekje për të eliminuar pengesën.

2. Pas njoftimit për ndërprerje, siç përcaktohet në paragrafin 1 të këtij neni, palët menjëherë marrin hapat e nevojshëm për të finalizuar aktivitetet e tyre sipas marrëveshjes, duke e bërë këtë sa ma shpejtë dhe në mënyrë të organizuar me qëllim të minimizimit të humbjeve dhe shpenzimeve shtesë.

Neni 8

Modifikimi i marrëveshjes apo shkëputja e saj

1. Kjo Marrëveshja e Bashkëpunimit, mund të modifikohet apo të shfuqizohet në mënyrë automatike me hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, fushëveprimi i të cilit prek ndonjë nga pikat e kësaj Marrëveshjeje, apo aktet tjera nënligjore dispozitat e të cilave janë në kundërshtim me këtë Marrëveshjeje.
2. Çdo ndryshim eventual i kësaj Marrëveshjeje duke përfshirë edhe vazhdimin konform procedurave të parapara bëhet në pajtim nga dy palët dhe do të shtohet si aneks dhe hynë në fuqi me nënshkrimin nga përfaqësuesit e Institucioneve që zbatojnë këtë Marrëveshjeje.
3. Secila nga palët mund të tërhiqet nga Marrëveshja brenda tridhjetë (30) ditëve pas paralajmërimit me shkrim duke i dhënë argumentet përkatëse;
4. Kohë e paralajmërimit do të merret data e pranimit të letrës paralajmëruese.

Neni 9

Anekset e marrëveshjes

Plani i detajuar i aktiviteteve dhe specifikave përkatëse është ANEKSI i cili është pjesë përbërëse e kësaj marrëveshjeje.

Neni 10

Hyrja në Fuqi

1. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në 4 (katër) ekzemplar origjinale, nga një për së cilën palë nënshkruese.

PALËT NËNSHKRUESE

Për:

APRK/ MPFVLÇ:

Z. Blerim Hasani

U.D Drejtor Ekzekutiv, APRK



Për:

Komunën e Drenasit

Z. Ramiz Lladrovci

Kryetar i Komunës



Prishtinë, 31 Mars 2026